



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 252 D. 13.04.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Rregulloren Disiplinore të FBK-së, si dhe në bazë të Ankesës së z. Endrit Basha të datës 10.03.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 13.04.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa z. Endrit Basha e datës 10.03.2023;
- II. ANULOHEM Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.03.2023;
- III. KTHEHET NË RIVENDOSJE Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.03.2023.
- IV. DETYROHEM Komisioni Disiplinor të shqyrtojë dhe vendosë lëndën në përputhje me udhëzimet e Komisionit Arbitrar.

ARSYETIM

Me datë 10.03.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e z. Endrit Basha mbi Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 08.03.2023 (tash e tutje: "Ankesa").

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 24.03.2023, 30.03.2023, dhe 06.04.2023, dhe ka trajtuar Ankesën. Në takime kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së, si dhe në takimin e datës 30.03.2023, z. Endrit Basha, i ftuar për të ushtruar të drejtën për tu dëgjuar si parashtrues i ankesës.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, z. Endrit Basha sfidon Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 08.03.2023, dhe konsideron se organi i shkallës së parë, ndër të tjera, ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe parimin *Audiatur et altera pars*, ashtu që nuk është marrë fare parasysh, e madje as që është dëgjuar versioni i tij rreth ngjarjes në fjalë.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Lidhur me Ankesën, Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Fillimisht, Komisioni Arbitrar vlerëson se ankesa është e bazuar duke marrë parasysh faktin se Komisioni Disiplinor, si organ i shkallës së parë, nuk i është përmbajtur Nenit 38 të Rregullores Disiplinore, i cili thekson se *'Komisioni disiplinor vendos në bazë të procedurës së zbatuar dhe deklaratave të dhëna nga pjesëmarrësit, të cilat mund të jenë në formë të shkruar apo gojore.'* Në rastin konkret, z. Endrit Basha nuk i është dhënë e drejta për tu dëgjuar apo mbrojtur në formë të shkruar, gjë që rezulton në shkelje procedurale nga organi i shkallës së parë. Kjo duhet kuruar nga ky Komision, dhe z. Basha duhet ftuar të paraqes mbrojtjen e tij qoftë në formë të shkruar apo gojore.

Për më tepër, sa i përket aspektit të së drejtës materiale, Komisioni Arbitrar vlerëson se baza juridike e përdorur nga organi i shkallës së parë nuk ka qenë e duhur. Vendimi i shkallës së parë bazohet në Nenin 55 të Rregullores Disiplinore, i cili dënon atë që *'vepron direkt apo indirekt kundër vendimeve të organeve të organizatës së basketbollit ose në mënyrë tjetër rrezikon autoritetin dhe efikasitetin e atyre organeve'*. Në rastin konkret nuk ka pasur mos-zbatim të vendimit për mos-kryerje të detyrës, kjo duke konsideruar se z. Basha nuk e ka kryer detyrën në kundërshtim me vendim, por ka kryer shkelje tjetër që Komisioni Disiplinor duhet të gjejë bazën ligjore që e adreson nëse veprimi i z. Basha është i ndëshkueshëm me Rregulloren Disiplinore të FBK-së. Veç kësaj, Komisioni Disiplinor duhet të mbledh fakte dhe të konfirmoj nëse z. Basha mban pozitë zyrtare në klub, sepse në bazë të Rregullores Disiplinore kompetenca për dënime i përket organeve të FBK-së vetëm ndaj klubeve dhe personave zyrtare të klubeve dhe jo ndaj shikuesëve. Për veprimet e dëmshme të shikuesëve përgjegjës mbahen klubet që organizojnë ngjarjen. Rrjedhimisht, edhe epilogu i vendimit të Komisionit Disiplinor varet nga gjetja faktike përkitazi me rolin zyrtar të z. Basha.

Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të parashtruara nga z. Basha në Akese dhe të njëjtat i ka gjetur të papabazuara.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Prandaj, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, Komisioni Arbitrar vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 13 prill 2023

Vendimi i dërgohet:

- Z. Endrit Basha
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor (si organ i shkallës së parë)
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



KËSHILLË JURIDIKE: *Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.*

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

